



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
REKTORATI

Nr. 756/ Prot.

Tiranë, më 07.03 .2023

VENDIM  
Nr. 27 , datë 07.03 .2023

PËR  
PROPOZIMIN E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT  
ME UNIVERSITETIN E SALENTOS, ITALI

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, në nenin 25 të Statutit të UST-së si dhe në vijim të procesit të ndërkombëtarizimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, Rektorati në mbledhjen e datës 07/03/2023,

VENDOSI:

1. Propozimin për nënshkrimin e marrëveshjes për bashkëpunim ndërkombëtar ndërmjet Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Universitetit të Salentos, Itali.
2. Ky vendim i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KAS





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
REKTORATI

Nr. 756/2 Prot.

Tiranë, më 07.03 .2023

VENDIM

Nr. 28, datë 07.03 .2023

PËR  
PROPOZIMIN E MIRATIMIN E ORGANIZIMIT  
TË NJË AKTIVITETI SOCIAL-KULTUROR PËR STUDENTËT E UST

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë', si dhe në vijim komunikimeve me Këshillin e Studentëve të UST-së, Rektorati në mbledhjen e datës **07/03/2023**,

VENDOSI:

1. Miratimin e organizimit të një aktiviteti social-kulturor për studentët e UST-së brenda muajit mars 2023.
2. Ky vendim i përcillet për mbështetjen financiare Administratorit të UST.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KAS





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
REKTORATI

Nr. 816/2 Prot.

Tiranë, më 13.03 2023

V E N D I M

Nr. 30 dt. 13.03 2023

**“PËR  
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STRUKTURËS MËSIMORE TË CIKLIT TË DYTË  
TË STUDIMEVE "MASTER PROFESIONAL - MENAXHIM NË SPORT DHE  
TURIZËM" NË FAKULTETIN E VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT,  
PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023”**

Mbështetur në nenin 3, 40 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 25 të Statutit të UST-së, në nenin 11 të Rregullores së UST-së, Vendimin e Senatit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës nr.88 datë 19.10.2022 “Për miratimin e strukturës mësimore të FSHL, FVFR dhe FSHR për vitin akademik 2022-2023” si dhe shkresën nr.765 prot., datë 07.03.2023 të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit “Kërkesë për ndryshimin e strukturës mësimore të ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional- Menaxhim në Sport dhe Turizëm”, në FVFR, për vitin akademik 2022-2023”, Rektorati në mbledhjen e datës 13.03.2023

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve në strukturën mësimore për programin e ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional- Menaxhim në Sport dhe Turizëm”, pranë Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, për vitin akademik 2022-2023. (Shkresa bashkëngjitur)
2. Periudha e zhvillimit të modulit “Aktivitete në natyrë- Stazh verë”, të ndryshojë nga 12.06.2023-21.06.2023 në 03.06.2023-12.06.2023.
3. Ky vendim t’i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.

REKTORI

Prof. Dr. AGRON KASARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
REKTORATI

Nr. 816/3 Prot.

Tiranë, më 13.03 2023

V E N D I M

Nr. 31 dt. 13.03 2023

**“PËR  
MIRATIMIN E PËRMBAJTJES DHE FORMËS SË DIPLOMËS DHE SUPLEMENTIT,  
PËR PROGRAMIN E CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” NË “TRAJNER I  
PËRGATITJES FIZIKE” NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË LËVIZJES”**

Mbështetur në nenin 40, 91 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Udhëzimin nr.10 datë 30.03.2020 të MAS “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, i ndryshuar, në Udhëzimin nr.11, datë 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës”, në nenin 25, 81 pika 2 të Statutit të UST-së, në nenin 11 të Rregullores së UST-së, në shkresën përcjellëse nr.808 prot., datë 13.03.2023 “Përcjellje për miratim e përmbajtjes dhe formës së diplomës dhe suplementit për programin e ciklit të dytë të “Master Profesional” në “Trajner i Përgatitjes Fizike”, të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Rektorati në mbledhjen e datës 13.03.2023,

V E N D O S I :

1. Miratimin e përmbajtjes dhe formës së:
  - Diplomës së programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Trajner i Përgatitjes Fizike” (formati bashkëngjitur)
  - Suplementit të Diplomës së programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Trajner i Përgatitjes Fizike” (formati bashkëngjitur)
2. Ky vendim t’i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.

REKTOR

Prof. Dr. AGRON KASAP





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
REKTORATI

Nr. 879/ Prot.

Tiranë, më 21.03.2023

VENDIM

Nr. 32, datë 21.03.2023

PËR

PROPOZIMIN E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT  
AKADEMINË "HEALTH COACHING", ITALI

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë', në nenin 25 të Statutit të UST-së si dhe në vijim të procesit të ndërkombëtarizimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, Rektorati në mbledhjen e datës **21/03/2023**,


VENDOSI :

1. Propozimin për nënshkrimin e marrëveshjes për bashkëpunim ndërkombëtar ndërmjet Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Akademisë "HEALTH COACHING", Itali.
2. Ky vendim i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

REKTORI

Prof. Dr. Agron KAS





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
REKTORATI

Nr. 945 Prot.

Tiranë, më 29.03 2023

V E N D I M

Nr. 53 dt. 29.03 2023

“PËR  
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN E PROGRAMIT TË STUDIMIT  
TË CIKLIT TË PARË BACHELOR  
“NË SHKENCAT E RAHABILITIMIT (FIZIOTERAPI)” NË FSHL”

Mbështetur në nenin 3 paragrafi 2, pika b, nenin 33 paragrafi 3, nenin 40 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7 paragrafi 2 pika b dhe 25 të Statutit të UST-së, në nenin 11 të Rregullores së UST-së, në vendimin e Senatit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës nr.61, datë 23.04.2021 “Për miratimin e Rregullore të programit të studimit të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit”, si dhe mbështetur në shkresën e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit nr.905 prot., datë 24.03.2023 “Propozim mbi ndryshimet në Rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Në Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi)” në FSHR, mbështetur në Vendimin nr.8, datë 28.03.2023 të Dekanatit të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit, Rektorati në mbledhjen e datës 29.03.2023

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Programit të Ciklit të Studimeve “Bachelor” në Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi) në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit. (bashkëlidhur).
2. Ky vendim t’i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.

REKTORI

Prof. Dr. AGRON KA

